

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË

“FERAR ENERGY” SHPK TIRANË

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2019

TË PËRGJITHËSHME DHE POLITIKAT KONTABEL

Shoqëria “FERAR ENERGY” SHPK, u regjistrua si biznes në datë 15/07/2009 me administrator Z.Ferid Sukaj, me objekt veprimtarie: Ndertimi, Operimi dhe transferimi i Hidrocenraleve "Benca dhe Tepelena" tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, projektimi, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpernarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike, ne zbatim te kontrates se koncesionit..Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT K91915001Q.

MBI POLITIKAT KRYESORE TË KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2019 janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901 të datës 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe të ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”

Kontabiliteti ishoqërisë “FERAR ENERGY” SHPK, është i organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit, si dhe ata të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm rregjistrimin e të dhënave por dhe marrjen e informacionit, respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël, ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2019 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërisë dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.


Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rumbullakime.

VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është i lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga cdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njëjtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë besueshëm nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.



SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

AKTIVI

AKTIVET MONETARE

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare ne vlerën **42,849 leke**, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumentave,përsa i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet e kryera.Diferenca e likuiditeteve për vlerën (131,088) lekë, e pasqyruar drejt në pasqyrën e fluksit monetar bashkangjitur bilancit, përputhet me pasqyrimin e tyre nëaktiv te bilancit.

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2018 **173,937 lekë**

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2019 **42,849 lekë**

Diferenca **(131,088) leke**

AKTIVI

AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

kërkesa të tjera të arkëtueshme në vlerën **4,400,176 lekë** ku kerfshihet llogaria 4456 "Shteti-TVSH e zbritshme".

INVENTARI

Inventari për vlerën **393,354,313 lekë**, përfshihet llogaria 332 "Punime ne proces"

SHPENZIME TE SHTYRA

Shpenzime te shtyra ne vleren **11,272,565 leke** nga llogaria 486 "Shpenzime te periudhave te ardhme"

AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktive të tjera afatgjata materiale me vlerë kontabël për vlerën **7,314,889 lekë**, ku përfshihet llogaria 2134 "Makineri dhe pajisje pune".


PASIVI

HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2019 detyrimet në total janë në vlerën **419,839,860 lekë** që nëmënyrë analitike janë si më poshtë :

Detyrimet afatshkurtra me vlerë totale **12,404,414 lekë**, ku përfshihen:

Te pagueshme nga aktiviteti i shfrytezimit ne vleren **1,003,597 leke** ku përfshihet llogaria 401 furnitore per mallra, produkte e sherbime".



Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 10,808,182 lekë, ku përfshihet: llogaria 421 "Paga dhe shpërblime" 10,744,518 lekë dhe llogaria 431 "Sigurime shoqërore dhe shëndetësore" 63,664 lekë.

Te pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën 5,200 leke ku përfshihet llogaria 442 "Tatim mbi të ardhurat personale.

Tituj huamarrje në vlerën 587,434 leke

Detyrime të shtyra në vlerën 101,154,564 leke, nga llogaria 4661 "afatshkurtra"

Detyrime afatgjata në vlerën 306,280,882 leke ku përfshihet llogaria 455 "Te drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve" 297,059,169 leke dhe llogaritë 4671 "Hua nga C&S CONSTRUCTION ENERGY" 217,000 leke, llogaria 4672 "Hua nga FERAR SHPK" 9,849,859 leke, llogaria 467 "Debitore të tjera, kreditore të tjera" në vlerën 142,676 leke.

KAPITALI

Gjendja e llogarive të Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vlerën (3,455,068) leke dhe përbëhet nga Kapitali i nënshkruar për 100,000 lekë dhe Fitimi i Pashpërndare (3,434,503) Fitimi i vitit ushtrimor 2019, marrë nga PASH, me vlerë (120,564) lekë.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2019 Shoqëria "FERAR ENERGY" SHPK ka realizuar shpenzime në masën 120,565 lekë nga veprimtaria e shfrytëzimit. Shpenzimet janë si më poshtë:


Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit 84,726 lekë ku përfshihet llogaria 657 "Gjoha dhe demshpërblime" 21,743 leke dhe llogaria 634 "Taksa dhe tarifa vendore" në vlerën 63,000 leke.

Shpenzimet financiare përfshijnë:

Llogaria 628 "Sherbime bankare" 35,839 lekë

MBI TË ARDHURAT

Shoqëria nuk ka realizuar të ardhura për vitin 2019.



PËRLOGARITJA E TATIM FITIMIT

FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT	(120,565)
SHPENZIME TE PANJOHURA	
TATIM FITIMI (15%).	0
FITIM/(HUMBJA) TATIMORE	(120,565)

PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte

Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në levizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në përfundim rezultton:

Mjete monetare në fillim 173,939 lekë
Mjete monetare në fund të periudhës 42,849 lekë
Rritja/rrenja neto e mjeteve monetare (131,090) lekë

Pra, ka përputhje të plotë të pasqyrës të fluksit monetar dhe gjendjes të aktiveve monetare të vendosura në aktiv të bilancit.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Eshtë plotësuar sipas kërkesave duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e kryera midis dy periudhave ushtrimore dhe ku gjëndja e këtyre kapitaleve të vet shoqërisë në fund të periudhës paraqitet me një vlerë prej (3,455,068) lekë cila paraqitet si në pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve, po ashtu edhe në postin e kapitaleve në pasiv të bilancit 2019.

SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime, nuk ka.

Duke patur parasysh shënimet e mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2019.

Tiranë , më 21.05.2020

Ekonomisti

Administratori

Migen Marku
Konsulling
sh.p.k.
R.K.
Rr. Komuna e Perisht, Tiranë

Ferid Vukaj
REPUBLIKA E SHQIPËRIE
FERAR ENERGY
Sh.p.k.
TIRANË - ALBANIA